

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E FUSHË –KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË, KOSOVO POLJE

Ekstrakti nga procesverbali, e trembëdhjetë - XIII, të Kuvendit të Komunës, e mbajtur me datën 23.12.2024, ora 10:00h, në Sallën e Kuvendit të Komunës.

Prezentë në mbledhje ishin anëtarët e Kuvendit të Komunës: Ali Ismaili - Kryesues i Kuvendit të Komunës, Bashkim Krasniqi - Zëvendës Kryesues i Kuvendit të Komunës për Komunitete. Mirlinda Krasniqi, Miranda Shabani, Jetmir Berisha, Vjollca Konjusha, Krenar Dumani, Laureat Gojnovci, Jahush Krasniqi, Fisnik Sllamniku, Etnik Berjani, Durim Hajra, Hasime Kostanica, Shpend Bardiqi, Habib Mekolli, Vlonjat Hasani, Mirsad Qyqalla, Dardane Sogojeva Shala, Migjen Kolshi, Qëndresa Ademi, Artan Asllani, Arbnore Kelmendi, Hasan Ismajli dhe Radoman Doderovic.

Mungojnë: Doruntina Jashari dhe Aida Alimi.

Kryetari i Komunës dhe Drejtorët e Drejtorive të Komunës: Besnik Osmani - Nënkryetar i Komunës, Amir Bullatovci - Drejtor për Administratë, Fatlum Berisha - Drejtor për Arsim, Bardhyl Kojçiçi - Drejtor për Infrastrukturë, Ardit Sekiraqa - Drejtor për Shërbime Publike dhe Mjedis, Ilir Hasani - Drejtor për Gjeodezi Kadastër e Pronë, Vjosa Kida Hyseni - Drejtore e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Të tjerë: Komandanti i Stacionit të Policisë në Fushë Kosovë - Bekim Zogjani dhe Përfaqësuesit e Kompanisë së INSI - Ismajl Baftiari dhe persona tjerë të kompanisë.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës përshëndeti të pranishmit në mbledhje, pas verifikimit të prezencës së anëtarëve të Kuvendit të Komunës, konstatoi se ekziston kuorumi për mbajtjen e mbledhjes dhe prezantoi këtë:

REND DITE

1. Aprovimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhjet e Kuvendit të Komunës e datës 26.11.2024.
2. Informatë për gjendjen e përgjithshme të sigurisë në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës janar - nëntor 2024.
3. Informatë lidhur me përgatitjen e Projekt-Planit Zhvillimor Komunal.
4. Propozim për shqyrtimin e parë të Projekt-Planit Vjetor të Punës së Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2025.
5. Shqyrtimi i parë i Projekt-Planit Komunal për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore.
6. Propozim për ndryshimin e vendimit Nr. 88, të datës 25.06.2024 për anëtarët e Komisionit për rekrutimin e Drejtorëve dhe Zëvendës Drejtorëve në institucionet arsimore të Komunës së Fushë-Kosovës.
7. Pyetje dhe përgjigje parlamentare.
8. Të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Përshëndeti të pranishmit në mbledhje. Lexoi pikat e rendit të ditës për shqyrtim në mbledhjen e sotme, anëtarë/e të nderuar të Kuvendit të Komunës, i kemi pasur tri rekomandime, të cilat nuk kanë kaluar në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa, rekomandimi i parë ka qenë kërkesa e raportit financiar të shpenzimeve për muajin janar - shtator 2024 nga Drejtoria e Financave dhe Buxhetit, e cila nuk ka kaluar në Komitetin për Politikë dhe Financa, pastaj ka qenë vendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e xhamisë i cili është kthyer si i kundërligjshëm, i cili në Komitetin për Politikë dhe Financa nuk ka kaluar dhe kërkesa e tretë ka qenë nga anëtarë i Lëvizjes Vetëvendosje z. Vlonjat Hasani, i cili ka propozuar që të merret një vendim për ndalimin e mjeteve piroteknike në prag të festave të fund vitit, unë si Kryesues i Kuvendit të Komunës, do ta hap debatin dhe pastaj do i qes në votim tri rekomandimet edhe në Kuvendin e Komunës.

Laureat Gojnovci: Përshëndetje për të gjithë, sa i përket rekomandimeve të cilat u thanë, ne nuk i kemi përkrah as në Komitet dhe as tani nuk do t'i përkrahim, ndërsa rendin e ditës në tërësinë e tij po.

Durim Hajra: Përshëndetje për të gjithë, sa i përket pikës së raportit financiar të shpenzimeve për periudhën janar - shtator 2024, mendoi se u deshtë një mbledhje e veçantë të jetë për këtë raport, ndërsa në këtë formë, të cilën ka ardhur po më duket si dyshuese, sepse vërejtjet tona kanë qenë të mëdha dhe në emër të Lëvizjes Vetëvendosjes, propozoi të shtyhet për mbledhjet e tjera, ndërsa dy pikat e tjera të cilat u propozuan i mbështesim nëse veç ka vullnet.

Mirsad Qyqalla: Përshëndetje për të gjithë, sa i përket pikës për raportin e shpenzimeve, ne e dimi që u deshtë në tetor me ardhur ky raport për shqyrtim, për çështje parimore ne nuk e përkrahim, ndërsa sa i përket vendimit i cili është kthyer nga ministria një ditë pas shpërndarjes së materialit të Kuvendit të Komunës, ne do ta votojmë, po ashtu pikën të cilin e ka propozuar asambleisti z. Vlonjat Hasani, mendoi se është një kohë e shkurtër dhe nuk ka nevojë me marrë një vendim.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Sa i përket pikës lidhur me vendimin i cili na është kthyer nga Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës, ju sqarova se ka ardhur një ditë pas shpërndarjes së materialit të Kuvendit dhe nëse nuk hyn sot si pikë shtesë, unë do ta sjell prapë në mbledhjen e radhës si pikë të rregullt.

Hasan Ismajli: Përshëndetje për të gjithë, sa i përket pikave shtesë, unë mendoj se raporti financiar ka ardhur me vonesë, mendoj se u deshtë me ardhur me kohë, tek pika dhënia në shfrytëzim e ngastrës kadastrale për ndërtimin e xhamisë, mendoj se nëse nuk kalon e kemi obligim në mbledhjen tjetër prapë me vendos në shqyrtim, sepse ky vendim kthehet që dy herë. Unë si asambleistë disa herë kam kërkuar nga drejtoritë e caktuara qasjen në dokumente zyrtare dhe nuk kam marrë përgjigje, unë propozoi një pikë shtesë, që Kuvendi i Komunës të marrë vendim, që Ekzekutivi i Komunës në çdo kërkesë të asambleistëve të përgjigjet për qasjen në dokumente zyrtare.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Unë mendoj se kjo punë nuk është gështje e Kuvendit, ju e bëni kërkesën për qasjen e dokumenteve zyrtare dhe nëse Ekzekutivi i Komunës nuk ju përgjigjet vazhdoni me instancat e tjera, sepse kjo është e rregulluar edhe me ligj.

Laureat Gjetrojevi: Duke parë diskutimin të cilin e dëgjuaam në si Grup Parlamentarë i Lidhjes Demokratike të Kosovës, nuk e mbështesim për shqyrtim asnjë pikë shtesë.

Pas sqarimeve Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e qiti në votim pikën e parë shtesë: Raportin financiar për buxhetin e shpenzuar për periudhën janar-shtator 2024, i ardhur nga Drejtoria e Financave dhe Buxhet.

U votua me: asnjë vota 'për', tre vota 'kundër' dhe asnjë abstenim, nga gjithsej njëzet e gjashtë anëtarët e pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës konstatoi se: Raporti financiar për buxhetin e shpenzuar për periudhën janar - shtator 2024, i Drejtorisë së Financave dhe Buxhetit, nuk hyn për shqyrtim si pikë shtesë e rendit të ditës, në mungesë të pjesëmarrjes në votim të anëtarëve të Kuvendit të Komunës.

Pas sqarimeve Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e qiti në votim edhe pikën e dytë shtesë: Kërkesën për rishqyrtimin e vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Xhamisë në Fushë-Kosovë, i kthyer në rishqyrtim nga Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës.

U votua me: nëntë vota 'për', asnjë votë 'kundër' dhe asnjë abstenim, nga gjithsej njëzet e gjashtë anëtarët e pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës konstatoi se: Kërkesa për rishqyrtimin e vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Xhamisë në Fushë-Kosovë, e kthyer në rishqyrtim nga Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës, nuk hyn për shqyrtim si pikë shtesë e rendit të ditës, në mungesë të pjesëmarrjes në votim të anëtarëve të Kuvendit të Komunës.

Pas sqarimeve Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e qiti në votim edhe pikën e tretë shtesë: Kërkesën për ndalimin e përdorimit të mjeteve piroteknike në prag të të festave të fund vitit.

U votua me: pesë vota 'për', asnjë votë 'kundër' dhe asnjë abstenim, nga gjithsej njëzet e gjashtë anëtarët e pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës konstatoi se: Kërkesën për ndalimin e përdorimit të mjeteve piroteknike në prag të festave të fund vitit, nuk hyn për shqyrtim si pikë shtesë e rendit të ditës, në mungesë të pjesëmarrjes në votim të anëtarëve të Kuvendit të Komunës.

Pas sqarimeve tjera procedurale Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e qiti në votim edhe pikën e katërt shtesë: Kërkesën e anëtarit të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës z. Hasan Ismajli, për qasjen në dokumente zyrtare.

U votua me: pesë vota 'për', asnjë votë 'kundër' dhe tri abstenime, nga gjithsej njëzet e gjashtë anëtarët e pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës konstatoi se: Kërkesa e anëtarit të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës z. Hasan Ismajli, për qasjen në dokumente zyrtare, nuk hyn për shqyrtim si pikë shtesë e rendit të ditës, në mungesë të pjesëmarrjes në votim të anëtarëve të Kuvendit të Komunës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Konstatoj se asnjëra nga pikat shtesë, nuk hyn në pikat e rendit të ditës për shqyrtim në mungesë të votave të shumicës së thjeshtë të anëtarëve të Kuvendit të Komunës.

Vlonjat Hasani: Ne propozuam si udalësë të përkohshme, për arsye se ka shumë lëndime gjatë kësaj periudhe kryesisht tek fëmijët dhe juve po ju duket e qullshme, ne do i shohim statistikën e të lënduarve pas festës. Sa i përket rendit të ditës, pika e shtatë tek 'Pyetje dhe përgjigje parlamentare', pse është prishur zakoni dhe dakordimi ynë këtu. Për arsye të korrektësisë ne i mbështesim pikat e rendit të ditës për shqyrtim në mbledhjen e sotme.

Mirsad Qyqalla: Lëvizja e pikës 'Pyetje dhe përgjigje parlamentare', nuk po më duket në rregull dhe kjo është arsyeja pse ne jemi kundër.

Hasan Ismajli: Ne jemi dakorduar që pika 'Pyetje dhe përgjigje parlamentare', të jetë aty ku ka qenë, sepse Kuvendi i Komunës i ka pikat e veta, pavarësisht se i kemi dy informata nga Komandanti i Stacionit të Policisë dhe përfaqësuesit e Kompanisë INSI.

Pas sqarimeve tjera shtesë dhe procedurale Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e qiti në votim për shqyrtim në mbledhjen e sotme rendin e ditës së propozuar.

U votua me: tetëmbëdhjetë vota 'për', tre vota 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej njëzet e një anëtarë të pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se anëtarët e Kuvendit të Komunës me shumicë të votave, e aprovuan për shqyrtim rendin e ditës së propozuar për mbledhjen e sotme.

Pika e parë (1) - Aprovimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës e datës 26.11.2024.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi për aprovim ekstraktin e procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës e datës 26.11.2024, hap diskutimin për vërejtjet dhe sugjerimet tuaja.

Durim Hajra: Unë çdo herë dua që ta potencoi, mos funksionimi i mikrofonave, shkoj viti dhe s'kemi mundur me bërë asgjë rreth rritjes së transparencës, publikimi i video-incizimeve të mbledhjeve të Kuvendit të Komunës. Një pyetje për ju Kryesues i Kuvendit të Komunës, a mundeni me na treguar se ku është problemi sa i përket publikimit të video-incizimeve të mbledhjeve të Kuvendit të Komunës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Unë nuk jam kompetent, kjo është punë e Ekzekutivit të Komunës dhe unë kam vetëm një votë këtu dhe ju kam mbështetur çdo herë, tjetër mekanizëm nuk kam.

Hasan Ismajli: Vërejtje tek faqja 13, tek përgjigja e Drejtorit për Kulturë Rini dhe Sport, një pyetje të cilën e ka bërë kolegu z. Migjen Kolshi, ma keni bashkangjitur mua.

Vlonjat Hasani: Kryesues i Kuvendit të Komunës a ka mundësi, sepse u bënë tri vite për rregullimin e mikrofonave me u ndërmarrë diçka.

Pas sqarimeve Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e qiti në votim për aprovim 'Ekstraktin e Procesverbalit, me ndryshimin të cilin e dha asambleisti paraprakisht nga mbledhjet e Kuvendit të Komunës e mbajtur më datën 26.11.2024'.

U votua me: gjashtëmbëdhjetë vota 'për', tetë vota 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej njëzet e katër pjesëmarrës në votim nga anëtarët e pranishëm në mbledhje.

Ne bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës me shumicë të votave e aprovoi 'Ekstraktin e procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës e mbajtur më datën 26.11.2024' me shikimin e vërejtjes të cilin e dha asambleisti paraprakisht.

Pika e dytë (2) - Informatë për gjendjen e përgjithshme të sigurisë në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës janar - nëntor 2024.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Fitoi Komandanti i Stacionit Policisë në Fushë-Kosovë z. Bekim Zogjani që ta marrë fjalën.

Bekim Zogjani - Komandant i Stacionit të Policisë në Fushë-Kosovë: Përsërisht për të gjithë të pranishmit, unë jam Bekim Zogjani Komandanti i Stacionit Policor të Fushë-Kosovës, më lejon të ju falënderoj për mundësinë që më keni dhënë, që unë sot para jush ta prezantoj një Raport mbi gjendjen e sigurisë në Komunën e Fushë-Kosovës për periudhën janar-nëntor 2024, i nderuari Kryesues i Kuvendit faleminderit, të ndëruar asambleistë faleminderit që ma keni dhënë këtë mundësi. Duke u bazuar në pozitën e mirë gjeografike që ka Komuna e Fushë-Kosovës, afërsinë me kryeqytetin, zhvillimi i hovshëm i zonave industriale, në dhe rreth qytetit, ndërtimet e larta si dhe çmimet e arsyeshme të banesave në Komunën e Fushë-Kosovës, kanë bërë që veçanërisht qyteti të jetë në fokus të shumë qytetarëve, nga të gjitha trojet shqiptare për të jetuar dhe punuar në Fushë-Kosovë, gjithë ky invazion i madh i qytetarëve për të jetuar në Fushë-Kosovë, edhe për kundër të mirave kanë sjellë edhe probleme, të cilat kanë kërkuar dhe kërkojnë angazhim dhe shtim të madh të aktiviteteve policore, gjatë periudhës raportuese janar - nëntor 2024, situata e sigurisë në zonën e përgjithësisë e stacionit të Fushë-Kosovës, ka qenë e qetë dhe nuk është shënuar asnjë rast i prishjes së rendit dhe qetësisë, në përmasa të mëdha, zona e përgjegjësisë së stacionit të Fushë-Kosovës është zonë multietnike, në të cilat jetojnë dhe punojnë të gjitha etnitë që jetojnë në Republikën e Kosovës, më lejon të ju informoi se gjatë periudhës raportuese janar -nëntor 2024, nuk kemi shënuar asnjë rast të dhunës ndëretnike apo incidenteve ndëretnike, në kuadër të kësaj periudhe ne i falënderojmë qytetarët e Fushë-Kosovës dhe gjithë qytetarëve tjerë, Kuvendit e Komunës së Fushë-Kosovës dhe ju të gjithëve këtu, që keni dhënë një kontribut në ofrimin e sigurisë, në përkrahjet e ndryshme që kemi pasur nga ju. Ky rezultat është arritur edhe falë bashkëpunimit me instanca tjera të sigurisë në nivel të shtetit, kjo ka bërë që trendi i krimit gjatë kësaj periudhe të ketë një rënie, po ashtu rezultatet e zbulimit janë më të larta, gjë që ka ngritur imazhin dhe besimin në Policinë e Kosovës, gjatë periudhës raportuese në stacionin Fushë-Kosovë janë të evidentuara gjithsej 1386 raste të ndryshme, ndërsa në periudhën e vitit 2023, kanë qenë 1687 raste, që do të thotë 18.6% raste më pak se në vitin 2023, prej tyre 1097 raste janë të zgjidhura apo 79.1%, ndërsa nën hetime kanë mbetur 289 raste të cilat nevojiten rezultate nga një institucion tjetër, këto raste janë në laboratorët për verifikime të ndryshme, pastaj në materialin të cilin e kam dërguar, besoj që e keni edhe një tabelë, në të cilën janë raportuar disa prej veprave penale të cilat janë më të rëndësishme. Më lejon që të ju njoftoi, se edhe për kundër të gjitha angazhimeve gjatë periudhës raportuese, nuk kemi të evidentuar asnjë rast vrasje, që në vitin 2023 i kemi pasur dy raste, lëndime të rënda trupore kemi 35.7% më pak, lëndime të lehta trupore kemi 8.2% më pak, vjedhje i kemi 48% më pak, vjedhje të rënda 47.6%, kemi dy raste të grabitjes më shumë se në vitin e kaluar, por edhe këto raste janë të zgjidhura, dhuna në familje si dukuri shqetësuese që e ka përfshirë gjithë Republikën e Kosovës, po ashtu edhe në Komunën e Fushë-Kosovës, ka pasur ndikimin e sajë edhe në Komunën e Fushë-Kosovës, ku ju njoftoi se gjatë periudhës raportuese kemi pasur 35.9% raste të evidentuara më shumë se në vitin 2023, një dukuri tjetër shqetësuese

substancat e ndryshme narkotike gjatë aksioneve të ndryshme policore, ka pasur identifikim dhe arrestime të personave të ndryshëm në 82 raste më shumë se në vitin e kaluar, apo 41.4%. Janë konfiskuar edhe 30 armë të ndryshme, të cilët qytetarët i kanë poseduar pa leje, municione të konfiskuara kanë qenë 206, të cilat kanë qenë të shoqëruara me armë, për njoftimin e juaj gjatë periudhës raportuese kemi pasur 238 persona të cilët kanë qenë të arrestuar dhe ndaluar në qendrën e ndalimit, prej tyre 5.1% më shumë se në vitin e kaluar. Afërsia me Gjykatën Themelore - Dega në Fushë-Kosovë, na ka lehtësuar punën, sepse bashkëpunimi ka qenë më i shpejtë mes policisë dhe gjykatës. Duke u bazuar në situatën e gjendjes së rënduar në komunikacion, me ardhjen e bashkatdhetarëve, me shtimin e bizneseve të ndryshme, në komunën tonë, qarkullimi i komunikacionit është rënduar shumë, por dua të ju informoi se, aksidentet në komunikacion kanë pasur rënie gjatë kësaj periudhe, ku në vitin e kaluar kanë qenë 460, ndërsa tani janë 272 apo minus 40.9%, gjatë kësaj periudhe ka pasur edhe shqiptim të gjobave në 6.3%, më shumë në krahasim me periudhën raportuese të vitit të kaluar, ku janë shqiptuar 11.903 gjoba në komunikacion, në kuadër të detyrave tona, njësitë tona policore kanë intervenuar edhe në raste të ndryshme të prishjes së rendit dhe qetësisë publike, që gjatë kësaj periudhe raportuese, kanë shqiptuar 360 gjoba apo 47.5%, më shumë se në periudhën e njëjtë të vitit 2023, një dukuri e cila ka qenë shqetësuese është në parkingje të ndryshme të automjeteve në vend e pa vend, ku ju njoftojmë se janë shqiptuar gjithsej 3801 gjoba në vitin e kaluar, tani janë gjithsej 3722 gjoba. Kemi angazhim edhe në ofrimin e sigurisë në objektet shkollore, edhe për kundër faktit se numri i nxënësve është shumë i lartë, gjendja e sigurisë është në nivel, ju njoftoi se kemi pasur disa raste, të cilat kanë ndodhur në afërsi të shkollave, kemi pasur edhe brenda hapësirave të shkollave, ku gjithsej i kemi të evidentuara 18 raste, vlen të cekim rezultatet e arritura në zbulimin e kryesve të veprave penale, ku është arritur falë projektit të realizuar nga Kuvendi i Komunës, me vendosjen e kamerave të sigurisë të cilat na kanë ndihmuar shumë në identifikimin dhe arrestimin e keqbërësve të ndryshëm, një falënderim i veçantë ju takon juve të nderuar/a anëtar/e të Kuvendit të Komunës, që një zëri keni aprovuar kërkesën për dhënien me qera të hapësirës së stacionit policor në Fushë-Kosovë, i cili projekt tani është në fazën, ku janë duke i përgatit dosjet për leje dhe besoj se në fillim të vitit 2025, do të fillojmë ndërtimin edhe të një stacioni, i cili do të na krijon kushte më të mira për punë për të gjithë stafin e personelit policor. Përveç këtyre rezultateve, sukseseve, po ashtu kemi pasur edhe vështirësi ku edhe kemi prapë, sa i përket logjistikës, sidomos me automjete zyrtare, më lejon që të ju falënderoi edhe një herë për dhënien e shfrytëzimit të një automjeti zyrtar, të cilën na e keni aprovuar ju si Kuvend i Komunës dhe jemi duke e shfrytëzuar në ofrimin e sigurisë për të gjithë nxënësit dhe punët tjera policore, kemi vërejtje nga qytetarët, që automjetet e ndryshme parkohen në vend e pa vend, një kërkesë të cilën e kisha pasur nga ju është që të shikoni mundësinë që të kontraktohet një kompani për tërheqjen e automjeteve, ku do të na lehtësonte punën ne si polici dhe të ju ofrojmë qytetarëve, një lëvizje të lirë. Andaj të nderuar asambleistë të Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës, në kuadër të gjitha këtyre rezultateve që i dëgjuat, ne nuk mund të jemi të kënaqur dhe të rrimë, sepse i kemi rezultatet e mira por, i kemi inkadruar të gjithë zyrtarët policor, që angazhimi i tyre të jetë maksimal, që të gjithë qytetarët e Komunës së Fushë-Kosovës, të ndihen të qetë dhe të sigurtë.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Ju falënderoi i nderuar z. Bekim Zogjani - Komandant i Policisë së Fushë-Kosovës.

Laureat Gjajnovci: Falënderoi të nderuarin z. Bekim Zogjani - Komandant i Policisë së Fushë-Kosovës, për raportin të cilin ua elaborove tani për këtë periudhë të vitit 2024, ju përgëzoi për punën të cilën ju e bëni në vazhdimësi, sepse puna juaj po shihet edhe në statistikat të cilat ne sot i kemi përballë, uroi që në bashkëpunim me qytetarët, rastet të jenë duke u zvogëluar çdo herë, sa i përket substancave narkotike edhe në nivel lokal, edhe në nivel qendror edhe organizatat e ndryshme jo qeveritare, janë përgjegjëse, për një vetëdijësim më të madh të komunitetit, me fushata vetëdijësuese me marrë masa nga më të ndryshmet, atëherë jemi përgjegjës edhe ne, edhe ju, për ndalimin e kësaj dukurie shqetësuese.

Durim Hajra: Falënderoi të nderuarin z. Bekim Zogjani - Komandant i Policisë së Fushë-Kosovës, uroi që të bëhet praktikë që çdo vit të vijë si pikë e rendit ditës 'Informata për gjendjen e përgjithshme të sigurisë në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës', sepse bashkëpunimi i institucioneve është për të mirën e qytetarëve, ku e kemi edhe obligim, kjo informatë ka qenë shumë e mirë se ardhur, po në qoftë se ka ndonjë bashkëpunim tjetër të cilin e vlerësoni, si stacion policore me asambleistë, ne jemi të hapur ashtu siç kemi qenë deri tani. Uroi që çdo herë të kenë siguri për qytetarët e Komunës së Fushë-Kosovës.

Mirsad Qyqalla: Falënderoi të nderuarin z. Bekim Zogjani - Komandant i Policisë së Stacionit të Fushë-Kosovës për: Informatën për gjendjen e përgjithshme të sigurisë në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës për periudhën janar - nëntor 2024, të cilën na elaboroi, e përmendet një pjesë të automjeteve që po parkohen vend e pa vend, mundësisht tani është edhe koha kur vijnë diaspora me u munduar minimalisht me bashkëpunuar dhe me reaguari. Unë e pata një kërkesë, tek pjesa e fëmijëve në shkollë, kishte qenë mirë në bashkëpunim me drejtorët me i njoftuar, edhe fëmijët që policia janë çdo herë në oborr të shkollave, ju përgëzoi dhe ju falënderoi për punën të cilën jeni duke e kryer.

Hasan Ismajli: Falënderoi të nderuarin z. Bekim Zogjani - Komandant i Policisë së Fushë-Kosovës për: Informatën për gjendjen e përgjithshme të sigurisë në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës, gjatë raportimit të Komandantit të Stacionit Policor në Fushë-Kosovës, ne sot nuk e kemi prezent në mbledhje, as Kryetarin e Komunës dhe as Nënkyetarin e Komunës, kjo është e çuditshme dhe nuk don koment. Unë e kam lexuar me shumë vëmendje raportin e juaj, andaj dua që të ju përgëzoi për punën e palodhshme të cilën jeni duke e bërë, sepse me ardhjen e juaj, ka përmirësime, andaj siguria e përgjithshme në çdo aspekt të sigurisë në komunën tonë është më e mirë, në një takim ku kemi ardhur ne, e kam cekur se është shumë mirë për qytetarët e Fushë-Kosovës, që keni ardhur ju në këtë pozitë, sepse askush më mirë se ju nuk e njeh Fushë-Kosovën në tërësinë e saj, ju përgëzoi dhe ju inkurajoi për punë, përkrahjen do ta kesh çdo herë. Kam dy pyetje nëse keni mundësi për përgjigje, prej 'Bau Marketit' e deri tek rreth rrotullimi Komuna e Fushë-Kosovës', ka vendos rrethoja në të dy anët e rrugës, unë pyes, a është zvogëluar apo rritur numri i aksidenteve dhe pyetja tjetër, vështirësitë e parkingjeve për arsye të uzurpimit të hapësirave publike, a keni problem me qytetarëve të cilat kanë probleme njëri me tjetrin. Ju dëshiroi punë të mbarë dhe suksese.

Zëvendës Kryesuesi i Kuvendit të Komunës për Komunitete: Falënderoj të nderuarin z. Bekim Zogjani - Komandant i Policisë së Fushë-Kosovës për: Informatën për gjendjen e përgjithshme të sigurisë në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës. Komandant edhe ju e ceket se komunitetët kanë siguri, ju kisha falënderuar se ne rend të parë është siguria, problemi që ne si komunitet kemi është dhuna në familje, ku mendoj se është si shkas i përdorimit të substancave narkotike, këtë vitë i kemi disa persona, të cilët kanë ndërruar jetë prej përdorimit të lëndëve narkotike. Ju dëshiroi punë të mbarë dhe suksese.

Artan Asllani: Falënderoj të nderuarin z. Bekim Zogjani - Komandant i Stacionit Policisë së Fushë-Kosovës për: Informatën për gjendjen e përgjithshme të sigurisë në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës. Jam i lumtur kur dëgjoj që Komuna e Fushë-Kosovës, nuk e ka të raportuar asnjë konflikt ndëretnik, ndryshe prej komunave tjera ku jemi dëshmitar të asaj të rastit të fundit në Komunën e Ferizajt, ku ndodhi një akte terroristë. Fushë-Kosova duhet të jetë model i komunave tjera se si bashkëjetohet. Unë kam një kërkesë, që patrulla policore të ketë më shpesh tek lagjja 028 dhe 029, sepse në atë lagje fatkeqësisht po përdoren komunitetet për arsye të substancave narkotike, ne jemi të gatshëm për bashkëpunim dhe parandalim të këtyre rasteve.

Fisnik Sllamniku: Falënderoj të nderuarin z. Bekim Zogjani - Komandant i Policisë së Fushë-Kosovës për: Informatën për gjendjen e përgjithshme të sigurisë në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës. Dua të pyes, a'ka ndonjë raport të veçantë, për përdorimin e lëndëve narkotike në shkolla, a ka ndonjë rritje dhe a ka pasur ligjërata më shumë për dhunën dhe substancave narkotike, a mundemi me ditë se deri ku ka shkuar kjo ligjëratë për nxënësit e shkollave.

Drejtori i Arsimit: Përshëndetje për të gjithë. Falënderoi të nderuarin z. Bekim Zogjani - Komandantin i Policisë së Fushë-Kosovës për: Informatën për gjendjen e përgjithshme të sigurisë në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës, e sidomos në institucionet edukativo-arsimore. Dua të ndalem tek pyetja të cilin e parashtroi z. Fisnik Sllamniku, nuk kemi asnjë rast të raportuar të narkotikëve në shkolla, ndërsa sa i përket nxënësve të cilët kanë përdorur substanca jashtë shkollave, raportin besoj që e ka policia. Falënderoj ekipin e policëve civil, të cilët kujdesen vazhdimisht për hapësirat shkollore, ne në bashkëpunim me stacionin policor, në fillim të këtij viti kemi marrë një vendim, që të mbyllim portat e shkollave, për arsye të rritjes së sigurisë për nxënësit e Komunës së Fushë-Kosovës, sepse komunikacioni afër shkollave është rrezik për nxënësit, dy rastet e fundit të cilat kanë ndodhur gjatë këtij viti, si rezultat i disa lojërave të Tik-tokit dhe intervenimi urgjent në bashkëpunim me policinë, ka rezultuar që gërvishtjet e duarve të nxënësve nëpër shkolla, nuk kanë ndodhë në shkollë, intervenimi ka qenë urgjent dhe është ndaluar kjo dukuri. Rastin e fundit e kemi, prapë me një lojë të Tik-tokit e quajtur supermen, edhe me këtë rast fal bashkëpunimit me menaxhmentin e shkollave, stacionin policor e kemi parandaluar dhe nuk kemi lëndime të rënda. Sa i përket sigurisë së përgjithshme, unë Komandantin e falënderoi, sepse është në gjendje të na përgjigjet në çdo rast, po ashtu falënderoi edhe Drejtorin e Drejtorisë së Inspektoratit për ndihmën. Ju dëshiroi punë të mbarë dhe suksese.

Bekim Zogjani - Komandant i Stacionit të Policisë: Unë mendoj se çështja e sigurisë në shkolla është prioritet, planifikimet tona, në këtë drejtim kanë qenë që katër zyrtar policor, me roba civile, janë vazhdimisht me detyrë në oborr të shkollave dhe në afërsi të shkollave, kanë kontakte ditore

me drejtorin, zëvendës drejtorin, sekretarin dhe personelin tjetër në shkollë, sa i përket rrethojave të rrugës, ato vende janë të dëmtuara, si pasojë që disa qytetarë të pandërgjegjshëm, i kanë hapur disa koridore dhe kalojnë rrugën dhe ka raste kur janë mroçikuar. Parkingjet nuk e kam saktë numrin, ka pasur sulme dhe lëndime. Shqetësimet për rastet e dhunës në familje, janë shqetësime edhe për ne, një numër i madh. Përdorimi i narkotikëve është e vërtetë, sepse përdoruesit në momentin që s'arrijnë me ble shfaqin dhunë, por ka edhe raste tjera. Patrullimet janë në tërë qytetin, po ashtu edhe tek lagjja 028 dhe 029. Ne me aq sa kemi kapacitete do ta bëjmë shtimin e patrullimit. Raporti për shkollë ka pasur ligjërata dhe të gjitha ato ligjërata, kanë qenë për dukuri të ndryshme negative. Ne si polici jemi të përkushtuar, maksimalisht që të gjithë qytetarët, të ndihen të qetë, të gjithë prindërit të shkojnë të punojnë dhe fëmijët e tyre të ndihen të sigurtë, gjatë rrugës, edhe në shkollë dhe kjo është që ne të ofrojmë një siguri maksimale, faleminderit shumë.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Të nderuar kolegë, në emër të pozitës së cilën e mbajë dhe në emrin e juaj e falënderoj komandantin për këto informacione për vitin 2024, uroi që kjo ramje e rasteve të na shoqëroi edhe më shumë në vitin që vjen, unë dua ta them një thënie, ku thotë se ai i cili zgjohet shëndosh dhe ka siguri, është njeriu më i pasur i kësaj bote, jemi falënderues për sigurinë komandant juve dhe gjithë stafit tuaj, bashkëpunimi jonë si Asamble Komunale me ju, ka qenë shumë i mirë, kemi pasur takime të vazhdueshme dhe po ju premtojmë që në vazhdimësi, kemi me vazhduar këtë bashkëpunim të mirëfilltë edhe në periudhën e ardhshme, faleminderit për kohën dhe informatat.

Pika e tretë (3) - Informatë lidhur me përgatitjen e Projekt-Planit Zhvillimor Komunal.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Tani ne e kemi një 'Informatë lidhur me përgatitjen e Projekt-Planit Zhvillimor Komunal', disa informata i kemi marrë nga ju i nderuari Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban edhe në mbledhjen e kaluar, andaj kërkoj që të jemi më të shkurtër dhe ne të informohemi vetëm për çështje të reja, që ne nuk i dijmë nga profesionistët e fushës, përfaqësuesit e Kompanisë INSI. Hap diskutimin.

Drejtori i Planifikimit Urban: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, po ashtu për përfaqësuesit e INSI-it të cilët i kemi këtu. Kjo është një informatë për procedurën për Kuvendin e Komunës, ndërsa sa i përket shqyrtimit publik, ajo fazë ende nuk ka ardhur. Plani Zhvillimor Komunal do të prezantohet në komunë dhe do të jetë i qasshëm edhe për qytetarët, për t'i dhënë komentet e tyre.

Ismail Baftiari - Përfaqësuesi i INSI-it: I nderuari Kryesues i Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës, të nderuar Anëtarë të Kuvendit të Komunës dhe ju drejtor të cilët jeni prezentë sot në këtë takim. Ne kemi bërë një punë shumë të gjatë, mirëpo prezantimi duhet të jetë shumë i shkurtër, por qëllimi i takimit të sotëm është vetëm me ju informuar ku jemi në proces të Planit Zhvillimor Komunal, sipas reformës ligjore në Komunën e Fushë-Kosovës bëhet për herën e parë, sepse komuna e ka një plan të viteve 2013-2023, por reforma e 2023 është për herë të parë që bëhet dhe kërkesa me reformën ligjore janë shumë më të ndryshme se kërkesat që kanë qenë më herët. Unë jam drejtori i Institutit INSI, i cili ka mbi 45 punëtorë, që punojnë me gjitha komunat, nuk kemi vija politike punojmë me të gjitha komunat në mënyrë profesionale. Më herët Komandanti i Stacionit Policor e përmendi numrin e madhe të gjobave për parkingjet, ato janë si shkas i mos planifikimit të duhur, dokumenti është një instrument, që duhet me lehtësuar procesin, u fol për problemet e trafikut, një prej rrugëve më të frekuentuara dhe më të rrezikshme që është në Kosovë, është fakt që komandanti tha, që nuk kemi shumë probleme, por me gjithë atë ka probleme në atë

rrugë dhe definitivishtë kjo punë i takon këtij dokumenti, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës, me trajtuar atë rrugë në mënyrë serioze, u fol për shkollat dhe sigurinë në shkolla, kemi raste në Kosovë kur janë lënë shkollat në një rrethim, janë vendosur kamerat dhe nuk i lejohej gjithkujt të hynte brenda shkollës dhe besoni se kjo i takon këtij dokumenti, ky dokument është më i rëndësishmi dhe roli juaj si anëtarë të Kuvendit të Komunës, të zgjedhur të popullit është jashtëzakonisht i madh. Ne për me pasur qasje i kemi vendos votë aplikacioni tonë dokumentin, ku çdo qytetarë, nëse hyn ueb-faqe të komunës hynë në Planin Zhvillimor Komunal, është linku, ku çdo e dhënë është në mënyrë digjitale, brenda dokumentit. Planin Zhvillimor Komunal është dokument strategjik, multidisiplinar dhe gjithëpërfshirës, punohet për tetë vite. Situata është e komplikuar por duhet të bashkëpunojmë të gjithë, për një Planin Zhvillimor Komunal sa më të mirë. Faza e parë është Planin Zhvillimor Komunal, faza e dytë Harta Zonale e Komunës, e cila është punuar më herët, ku përfshihen strategjitë lokale, strategjia për arsim, strategjia për mjedis, strategjia për shëndetësi. Jemi detyruar me u bazuar në Planin Hapësinorë të Kosovës me interes të veçantë dhe jemi detyruar me u bazuar edhe në planet tjera, jemi detyruar edhe në agjentat ndërkombëtare, ndryshimet klimatike, ekonomia qarkore të gjitha këto shteti jonë i zbaton si dokumente të planifikimit, si dokument është kërkuar me qenë komplet të dhëna digjitale dhe ka shumë indikatorë, të cilët janë kërkuar dhe ka shumë vështirësi, me i siguruar këta indikatorë, mundeni me pa edhe në dokument dhe nëse ka ndonjë lëshim ju kisha lutur që të reagoni, sepse sa ma shumë vërejtje dhe sugjerime dokumenti do të jetë më i mirë. Vlerësimi i gjendjes është pjesa e dytë e dokumentit, këtu identifikohen, probleme, përparësitë, mangësitë, trendet zhvillimore, plani ka dhjetë fusha tematike, fusha e parë është zhvillimi ekonomik, ku trajtohet turizmi, bujqësia me vreshtari, pemëtari, agro-industri, industria ku ka me qenë zona industriale, korridori me Prishtinën nuk është i planifikuar, në drejtim Drenasit nuk është i planifikuar, me këtë dokument vendoset një kufi qysh ka me u zhvilluar ky korridor. Pasuritë nëntokësore që potencialisht, mundet me i pasur Fushë-Kosova dhe që realisht munden me u përdorë, ndërtimtaria ku prodhohen ato materiale si i drurit, plastikës, metale, është pjesë e planifikimit gjithë çka është në fushë të trajtimit, zonat ku kanë me u definuar dhe zhvilluar i trajton ky dokument. Fusha e dytë Infrastruktura Publike, ujësjellësi, kanalizimi, furnizimi me energji elektrike, telekomunikimi komplet fusha teknike. Infrastruktura publike dhe sociale komplet hapësirat, duke filluar nga objektet fetare deri tek shkollat, çerdhet, Qendrat e Mjekësisë Familjare, Ambulancat e Mjekësisë Familjare, planifikohen si hapësira në këtë dokument, e nëse nuk i kemi në këtë dokument është problem pastaj me Ministrinë e linjës, pse nuk i kemi sistem, shikoni me vëmendje të gjitha këto, shkolla, çerdhe, fusha sporti, varrezat dhe jepni kontributin e juaj si anëtarë të Kuvendit të Komunës. Fusha tjetër, është fusha e vendbanimit, banimeve dhe vendbanimeve formale, vendbanimet joformale janë vendbanime që janë identifikuar në vitin 2005, nga Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës dhe janë vendbanime që sot aty janë qytetarë tonë, është një zonë që ose ka ndërtuar në pronë publike ose prona që nuk e kanë definuar pronësinë, ose infrastruktura ka qenë e dobët, ose ka qenë e pa planifikuar, ose ka edhe raste kur Fushë-Kosova ka edhe komunitete jo shumicë dhe mundët me kanë diskriminuese, i kemi disa vendbanime jo formale.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Po besoj se e patët shumë të vështirë tërë këtë volum me prezantuar për një kohë shumë të shkurtër, unë nga pozita e asambleistit, kam shumë pyetje për të bërë të adresuara nga qytetarët e Fushë-Kosovës për vështirësitë të cilat i kanë, sepse si komunë është shumë e ngarkuar, unë jam në dijeni se kjo është veç fillimi dhe besoj që vitin e ardhshëm do të përmbyllet, unë do të jap komentet e mia me shkrim kur ju të filloni me debatin publik me qytetarët, unë do të kërkoj nga Drejtori i Drejtorisë së Planifikimit Urban që të na përgatit një planë

për debat me bizneset, qytetarët dhe një debat gjithëpërfshirës që ta kem mundësinë, edhe ne nga këndi jonë t'i ftojme bizneset, sepse ka shumë kërkosa, sepse unë ngriti vazhdimisht problemin e varrezave në Fushë-Kosovë dhe kemi një problem të madh, i cili do të shoqëroi menjëherë vitin e ardhshëm, për arsye të hapësirës. Po ashtu zona industriale, ku është betonjerka e 'Cima Construction', ku Kuvendi i Komunës ka marrë një vendim i cili nuk lejon tonazhe të rënda me kamion anëj dhe janë duke u ballafaquar me këtë problem, bizneset në atë pjesë dhe me parashikuar mundësinë se si mundemi me ju ndihmuar dhe shumë çështje tjera, të cilat do t'i ngriti të gjitha me shkrim.

Fisnik Sllamniku: Përshëndetje për të gjithë. Plan Zhvillimor Komunal është dokumenti më i rëndësishëm, ky plan ka shumë detaje të cilat nuk kemi mundur me i diskutuar të gjitha, a është paraparë një strategji dhe veprime për zbatim, në kuadër të këtij plani, a'ka edhe një plan të veprimit, këtu janë paraparë, afatet kohore edhe implikimet financiare dhe duke i paraparë këto implikime financiare, a'janë paraparë me regjistrimin e fundit të popullsisë. Ky Plan Zhvillimor Komunal bëhet me këto problematika, në afat prej tetë viteve, dua të pyes, a parasheh ky plan prioritetet, sepse nuk mundën të gjitha me hy në plan në të gjitha fushat, çështja e transparencës pa dyshim se duhet me qenë, a'ka pasur ekspertë të fushave të caktuara, të këtij planifikimi zhvillimor komunal shembull tek shëndetësia, arsimit, që i shërbejnë këtij plani, sepse neve na duhen ekspertat e fushave të cilët bëjnë planifikim. Plan Zhvillimor Komunal, a parasheh urgjencat të cilat mundën me u shfaqur gjatë kohës së zhvillimit të tij.

Durim Hajra: Sa i përket kësaj pike, unë duke marrë parasysh, rëndësinë e këtij dokumenti, që është një prej dokumenteve strategjike të një komune. Meqë nuk kemi një pjesë grafike, besoj se jemi të kufizuar edhe në atë se çka mundemi me thënë, unë kam bërë përpjekje me gjete në uebfaqe të komunës dhe nuk kam mundur me gjetë, unë e gjeta Planin Zhvillimor Komunal të vjetrin, mirëpo jo këtë, unë jam i kufizuar dhe nuk di, si të jap shpjegime, edhe qytetarëve të cilët janë të interesuar që e kanë parë në rendin e ditës si pikë që është, unë kam përcjell edhe aktivitetin e drejtorisë, e cila ka bërë disa takime, me komunat me të cilat kufizohemi, edhe një takim këtu në sallën e Kuvendit të Komunës, ku është prezantuar diçka dhe fatkeqësisht Kuvendi i Komunës, i cili e morre këtë vendim dhe e ka barrën kryesore, për të vendosur për këtë vendim, nuk ka qenë i ftuar fare, edhe pse thirrja ka qenë publike, por ne nuk jemi thirrur në cilësinë e asambleistëve. Pyes cilat kanë qenë sfidat për me ardhur deri tek një projekt, i cili sot asambleistët është dashur që ta kenë përpara, duke marrë parasysh specifikat e zhvillimit të aspektit infrastrukturor të Komunës së Fushë-Kosovës, mendoj se ka ende hapësirë në Komunën e Fushë-Kosovës, me punuar dhe me planifikuar diçka nga zhvillimi ekonomik, besoj që ka qenë problematike, edhe për ekspert që me paraparë dhe me gjetë zgjidhje adekuate për infrastrukturën publike. Unë mendoj se nuk është problem me identifikuar dhe me i planifikuar në aspektin hartografik vendbanimet në fshatra, sepse nuk e kanë fatin si të qytetit, unë mendoj se është shumë sfiduese edhe aspekti i shërbimeve publike, një gjë që është njëra prej pikave kryesore, zyrtari nuk e shpjegoj një prej pikave kryesore, se ku bazohet për një Plan Zhvillimor Komunal, e që është pjesëmarrja e qytetarëve për qeverisje të mirë. Këto vërejtjet janë përmbajtësore dhe i kontribuojnë për ta nxjerrë një plan sa më të mirë zhvillimor komunal. Në Komunën e Fushë-Kosovës, pjesëmarrja e qytetarëve ka qenë e mangët, të paktën për punën të cilën është bërë deri tani, është dashur me i nxjerr qytetarët që të marrin pjesë për të dalur një plan sa më i mirë.

Mirsad Qyqalla: Përshëndetje për përfaqësuesit e INSI-it, ky dokument jep drejtimin për tetë vitet e ardhshme të qytetit tonë, edhe unë kam disa pyetje, të cilat janë me interes të veçantë, unë pajtohem me kolegun që sot kemi me pasur mundësinë, përmes sllajdeve me pa, ku prej gjendjes ekzistuese kemi paraparë këto ndryshime, ku po duam me shkuar dhe ku po duam me dalë. A

parasheh ndonjë masë, nëse nuk zbatohet, sepse komuna jonë qalon në aspektin e zbatimit. Ne nuk jemi ekspert të secilës fushë, dëgjova përfaqësuesin i cili tha me regjistrimin e ri të popullsisë, ne duhet me i prek disa pjesë dhe pyes, pse nuk është pritur me numrin përfundimtarë të regjistrimit të popullsisë, po ashtu për ta bërë një plan të mirëfilltë, duhet me pasur qasje në dokumente të komunës, për ta nxjerr një plan sa më konkret, duke e parë vështirësinë e qasjes në dokumente zyrtare edhe për ne që jemi asambleistë, unë po u'a parashtroi pyetjen, se a'kemi pasur ju vështirësi të tilla, kur kemi pasur nevojë për ndonjë dokument dhe a ju kanë ofruar ato, sepse neve nëse na është dashur, me i pa hapësirat gjelbërues, nuk na është dhënë mundësia asnjëherë, një pjesë tjetër që është interes i qytetarëve të Fushë-Kosovës, është pjesa e zonës së Uglarit, e cila në Hartë Zonale të Komunës nuk është e përfshirë. Ju thotë se gjithëpërfshirja për ne është shumë lehtësuese, kishte qenë mirë që Drejtori i Drejtorisë së Planifikimit Urban me i caktuar disa debate me qytetarë edhe në fshatra, unë kisha propozuar me pasur një pikë të veçantë, e të na sqarohet me sllajde dhe me parë kah po shkon drejtimi i zhvillimit të qytetit në të ardhmen.

Hasan Ismajli: Përshëndetje për të gjithë, gabimi më i madh prej Ekzekutivit të Komunës ka qenë hartimi i Hartës Zonale të Komunës, para Planit Zhvillimor Komunal dhe ju si kompani, kur e keni parë Hartën Zonale Zonale, unë jam i bindur që ka pasur ndërhyrje në punën tuaj, edhe nga Kryetari i Komunës edhe nga ish Drejtori i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe e kemi këtë katrohurë kështu siç është dhe tash me Planin Zhvillimor Komunal, duhet me u përshtat harta zonale sipas Planit Zhvillimor Komunal dhe kjo i bjen, shpëto çka ka mbet me shpëtuar, me hartë zonale ka pasur ndërtim deri tek Hekurudha, vetëm një ngastër kadastrale jashtë hekurudhës, që shkon atje pas Hekurudhës, është një depo e hekurave dhe me hartë zonale aty parashihet ndërtim i lartë, këtë mundesh me vërtetuar duke e shikuar hartën zonale, po ashtu drejtori është këtu dhe mundet me të treguar. Ju e përmendët zhvillimin ekonomik, unë po bëjë pyetje prej qytetarit mbi 55 vite me banim në Fushë-Kosovë, sepse e njoh shumë herët, po flas për qytetin, a mund ta përballon kjo sipërfaqe tërë këtë ndërtim dhe gjithë këta banorë, kur kemi probleme me komplet infrastrukturën dhe është shumë e vështirë me banuar në qendër të Fushë-Kosovës, në Fushë-Kosovë sipas statistikave të dhëna nga Agjensioni i Statistikave të Kosovës janë mbi 60 mijë banorë dhe këta kërkojnë shkollim, shëndetësi, çerdhe dhe shumë gjëra të tjera, të cilat janë të lidhura me jetën e përditshme të këtyre banorëve. Prona komunale ka shumë pak, ato të cilat kanë qenë, nuk janë dhe nuk e di se sa prona komunale, u'a kanë ofruar juve dhe çka keni paraparë në ato prona. A keni paraparë ku do të jetë hapësira e varrezave, sepse ashtu siç e tha Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, këtë çështje ne e ngritëm çdo herë, nuk ka vend më, statistikave e vdekjeve në Fushë-Kosovë, janë brenda vitit mbi 200 vdekje dhe në qytet janë 80. Çështje tjetër është ujësjellësi dhe kanalizimi, unë kur kemi pasur debat publik ju kam treguar që pjesën më të madhe është i viteve të 70-ta dhe ka shumë nevojë për ndërhyrje. Unë mendoj se Plani Zhvillimor Komunal, është Kushtetuta e Komunës dhe qyteti i Fushë-Kosovës, ka shumë probleme me infrastrukturë. Unë pyes, ku keni paraparë gjelbërim, ku keni paraparë një shkollë, një çerdhe. Tani duhet me hy në bashkëpunim me ndërtuesit dhe pronarë të pronave private, për me dhënë hapësirë për me i marrë 20 ari, pyes, a ua merr mendja ju si kompani, që e bëni një Planë Zhvillimor Komunal, që mundet një shkollë me u ndërtuar me 20 ari, me 2000m², sepse ne i kemi tri të shkolla të ndërtuara, e katërta ka filluar tani dhe nuk ka kushte për këta nxënës, ju doni vetëm ndërtime të larta, sepse mundësi keni pasur një lagje këtu afër me ndërtuar me shtëpia, e keni mbi populluar komunën dhe është bërë një jetë e vështirë për qytetarët e Komunës së Fushë-Kosovës, sepse këta jetën e tyre personale e kanë të qetë, sepse jetojnë në fshatra dhe ato banesa të cilat i kanë këtu i kanë vetëm për biznes, po ashtu as fëmijët nuk i shkollojnë këtu, duke filluar nga Nënkryetari i Komunës, qytetarëve të Komunës së Fushë-Kosovës, është duke i'u renduar jetesa si qytetarë. Unë kam shumë vërejtje në shumë

pika dhe duhet të kemi kujdes, sepse nesër fajli ka me qenë i përbashkët, i juve si Kompani dhe i Ekzekutivit të Komunës. Ne kemi pasur problemin me Xhaminë, ku në atë ngastër kadastrale me Hartë Zonale të Komunës, është paraparë shkollë, këtu i kanë pasur votat e kanë votuar, por ajo çka ka qenë e rëndësishme, është në ka dalur drejtori në foltore dhe ka thënë: po kemi të drejtë me dhënë atë pjesë dhe e shkollë Hartën Zonale të Komunës, e bjen dy herë në votim dhe Ministria e kthen dy herë, me shumë të drejtë. Kemi kujdes edhe tek kanalizimet, ujësjellësit, e tek të gjithat.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Ne i kemi marrë shumë vendime, të cilat na u kanë kthyer nga Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës, si vendime të kundërligjshme, përfshirë edhe shkollat të cilat janë ndërtuar, e të cilat nuk kanë qenë në përputhshmëri me Hartën Zonale të Komunës dhe as me Planin Zhvillimor Komunal, këtu po preket secili qytetarë, qoftë në një formë apo një tjetër, unë mendoj se ju jeni ekspert i nderuar përfaqësues i INSI-it, ne mundemi me i ngrit disa çështje me qëllim, që ju me i pasur parasysh dhe me u munduar me i zgjedh në mënyrën më të mirë të mundshme. Ky është veç fillimi dhe do kemi hapësirë me debatuar edhe në debat publik, edhe në Kuvendin e Komunës prapë. Kishte qenë mirë që t'iu jepet linku të gjithëve, që të kemi qasje të gjithë.

Habib Mekolli: Më duket Hartën Zonale të Komunës dhe Planin e Mobilitetit të Qëndrueshëm Urban, e ka punuar i njëjti institucion dhe është paguar prej taksave të qytetarëve, tani e ka marrë për sipër edhe hartimin e Planit Zhvillimor Komunal dhe në bazë diskutimeve, u pa qartë se tek plani i mobilitetit, është duke dështuar, tani a nuk keni punuar ju si duhet, apo nuk po zbatohet prej zbatuesve, e njëjta është edhe me hartën zonale, ne jemi dëshmitar që është duke u punuar me standarde të njëjta, jo të mira në zonën e re, të cilën e keni paraparë ju për ndërtime të larta, po shpresoi se ka me qenë një qasje më serioze, tek hartimi i këtij Planit Zhvillimor Komunal, meqenëse është dokumenti më i rëndësishëm i një komune.

Drejtori i Planifikimit Urban: Po ndërlidhem tek asambleisti z. Durim Hajra, tek pjesëmarrja e qytetarëve, ne e kemi bërë ashtu siç e parasheh edhe Udhëzimi Administrativ, për hartimin e planeve hapësinorë, konkretisht Planit Zhvillimor Komunal, kemi organizuar debate dhe diskutime publike në datat e caktuara, të cilat unë i kam raportuar edhe në raportin e parë, edhe në raportin e dytë, mirëpo ne nuk jemi fajtor pse pjesëmarrja është e dobët, përndryshe ne kemi organizuar diskutim publik edhe me pjesëtarët e institucioneve të ndryshme publike, përfaqësues të ndryshëm të KEK-ut, KEDS-it, Infrakos-it, FSK-së dhe institucione tjera, të cilat i kanë shprehur çështjet e tyre me interes, e që ne i kemi përfshirë në Planin Zhvillimor Komunal, me qëllimin që ne me qenë transparentë dhe mos me dërguar Planin Zhvillimor Komunal në një fazë finale, pa ju njoftuar vazhdimisht për rrjedhën dhe procedurën, por edhe sasinë e punës, e cila është bërë deri tani, ne edhe sot kemi ardhur me këtë informatë, e cila më shumë ka të bëjë me procedurën, deri ku kemi arritur, për zhvillimet të cilat janë duke u paraparë, qasja në linkun e komunës për Planin Zhvillimor Komunal është aktive, i qasshëm, mundohuni mu kyqur, sepse unë tani e provova dhe pata qasjen, po ashtu konsultova edhe zyrtarin e - IT, bashkangjitur keni komplet pjesën tekstuale, profilin ekzistues, gjendjen ekzistuese. Ky link është i qasshëm për të gjithë. Ngriti një çështje asambleisti z. Hasan Ismajli tek zona e Hekurudhës, nuk është ndërtim i lartë, mundeni me u vërtetuar, është e saktë, po ashtu ngrite edhe çështjen e kanalizimit, ujësjellësit e shumë të tjera, mirëpo INSI këto i ka elaboruar, në pjesën hartografike, është projekt që zhvillohet prej KKM-së, në bashkëpunim me ujësjellësin 'Prishtina', ne i kemi futur këto të dhëna të cilat i kemi marrë nga ata.

Durim Hajra: Drejtor tek pjesa, e pjesëmarrjes së qytetarëve, nuk thash që është zero, por thash që duhet me e gjetur modalitet, që me u'a marr vëmendjen qytetarëve për këtë. Pyetja prapë është deri kur kemi arritur me këtë dokument? Intersimi ka qenë i mirë për atë sa kom miq e shokë në

rrjetet sociale nga dita, kur unë e kam publikuar ftesën për Planin Zhvillimor Komunal. Nuk thash që dokumenti nuk është i publikuar.

Drejtori i Planifikimit Urban: Ne e vërtetësojmë që dokumenti është i qasshëm, mundësia është, ne i kemi respektuar udhëzimet administrative. Unë kam dalë çdo herë për informata sepse kam dashur me qenë transparentë. Ne e respektojmë Udhëzimin Administrativ për Planin Zhvillimor Komunal.

Ismail baftiari - Drejtori i Kompanisë INSI: Fillimisht ju falënderoj për komentet dhe shqetësimet që i keni ngritët, sepse këto komente dhe shqetësime që ju i keni ngrit janë shqetësime edhe tonat. Planin Zhvillimor Komunal dhe Harta Zonale e Komunës janë obligim i komunës ligjërisht. Zbatimi ose hartimi, këtu Harta Zonale e Komunës në Komunën e Fushë-Kosovës, ka qenë dokumenti i parë i cili është punuar, baza e këtij dokumenti ka qenë minimale, është bërë në mënyrën më të mirë të mundshme në aspektin profesional në përputhje me gjendjen ekzistuese dhe rrjedhën e zhvillimit të komunës në zonën urbane dhe zonën për zhvillimin e bizneseve. Zbatimi i Planit të Mobilitetit të Qëndrueshëm Urban është i paraparë në disa fazë, parasheh krijimin e parkingjeve, sot këtu e dëgjova edhe propozimin për hapësirën e varrezave, secilën çështje deri në fund të procesit do të mundohemi ta adresojmë, lidhur me Aeroportin e Prishtinës, kemi qenë të obliguar të zbatojmë rregullat ndërkombëtare, këtu u përmendën edhe hapësirat e pamjaftueshme për shkollë në qytet, ju këto çështje që duhet të zhvillohen në qytet duhet t'i parashihni edhe me Komizën Afatmesme Buxhetore. Linku dhe qasja në të duhet të rregullohet, u sqarua edhe nga Drejtori për Planifikim Urban mënyra e qasjes, ne jemi shtet demokratikë dhe duhet të diskutojmë, secilën çështje para procesit të vendim marrjes, edhe çështjen e rrugëve që shumica janë nga katër metra, në disa zona ato duhet të zgjerohen deri në dhjetë metra. Varrezat janë paraparë tek pjesa e zonës industriale, edhe secili propozim tjetër duhet të shqyrtohet dhe të vendoset në projektet e viteve 2025, 2026 dhe në vazhdimësi, ku dokument është për të mirën e të gjithëve, duhet të tejkalon politikën e momentit, duhet të përkrahen projektet me rëndësi strategjike. Për këtë plan zhvillimor duhet të komunikohet edhe me institucionet tjera, duhet të mirret parasysh gjendja faktike, gjendja pronësore, sepse nga këto zhvillime ndryshohen planet e qytetarëve, dikush e jep pronën, dikush nuk e jep në një fazë të caktuar të zhvillimit të përgjithshëm.

Drejtori për Planifikim Urban: Tani e keni linkun, ai hapet, ju e dini çështjen e bonuseve të zonimit për ndërtime me kompenzim, ne me bunuse i kemi ndërtuar edhe objektin e shkollës, njësoi jemi duke vepruar edhe për shkollën tjetër në qytet, synimi jonë është që të gjejmë lokacionet më të përshtatshme për objekte me karakter publikë për shoqërinë tonë.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Kuvendi i Komunës duhet të pajiset me listën e pronave komunale, të cilat ne nuk i kemi.

Mirsad Qyqalla: Unë këtu dua të paraqes ndjenjat e qytetarëve të zonës së Uglarit, të cilët kanë telashe, sepse ata numërohen si banorë zyrtarë të Komunës së Graçanicës, ndërsa marrjen e shumë shërbimeve e kanë në Fushë-Kosovë, a mund të bëhet ndonjë lëvizje përmes shpronësimeve, për zgjidhjen dhe trajtimin e kërkesave të këtyre banorëve, sepse ata nuk janë fajtor që janë gjendur në këtë situatë formalo-juridike dhe statusore.

Ismail baftiari - Drejtori i Kompanisë INSI: Ne jemi takuar me banorët e kësaj zone të Uglarit, për këtë çështje kemi biseduar edhe me zyrtarët e Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës, por këtu kemi të bëjmë me Ligjin për Kufijtë Administrativ dhe vendimet për zgjidhje duhet të merren në nivelin shtetërorë.

Koha e pushimit të mbledhjes në kohëzgjatje prej një ore.

Pika e katërt (4) - Propozimi për shqyrtimin e parë të Projekt-Planit të Punës së Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2025.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Të nderuar kolegë, ne kemi formuar me vendim Grupin Punues për përgatitjen e 'Planit të Punës së Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2025', jemi takuar tri herë për këtë plan të punës. Hap diskutimin.

Jetmir Berisha: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Ne i kemi dhënë idetë tona, e përkrahim për aprovim në parim 'Projekt-Planin e Punës së Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2025' dhe besoj se do ta kemi përkrahjen e të gjithëve, sepse kemi punuar bashkë në këtë çështje.

Durim Hajra: Ne e kemi pasur një propozim të veçantë për 'Inicimin e procedurës për ndryshim-plotësimin e Statutit të Komunës së Fushë-Kosovës', të tjerat e dijmë që janë përfshirë të gjitha, por në këtë çështje me rëndësi nuk kemi pasur harmonizim dhe përkrahje.

Mirsad Qyqalla: Drejtoritë të cilat ndajnë subvencione, me na informuar me kohë dhe me u sistemuar me radhë sipas kohës kur ato i ndajnë subvencionet.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Unë e qes në votim propozimin të cilin e dha asambleisti z. Durim Hajra për 'Inicimin e procedurës për ndryshim-plotësimin e Statutit të Komunës së Fushë-Kosovës'.

U votua me: shtatë vota 'për', asnjë votë 'kundër' dhe asnjë abstenim, nga gjithsej njëzet e gjashtë anëtarët e pranishëm në mbledhje.

Ne bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës nuk e aprovoi 'Kërkesën për inicimin e procedurës për ndryshim-plotësimin e Statutit të Komunës së Fushë-Kosovës'.

Pas sqarimeve tjera Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e qiti në votim 'Propozimin për shqyrtimin e parë dhe aprovimin në parim për diskutim publik të Projekt-Planit të Punës së Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2025'.

U votua me: trembëdhjetë vota 'për', asnjë votë 'kundër' dhe asnjë abstenim, nga gjithsej njëzet e gjashtë anëtarët e pranishëm në mbledhje.

Ne bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës në mungesë të votave nuk e aprovon në parim për diskutim publik 'Projekt-Planin e Punës së Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2025'.

Pika e pestë (5) - Shqyrtimi i parë i Projekt-Planit Komunal për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Sqaroi se Drejtori i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, më ka lajmëruar në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa, se nuk mundet të marrë pjesë në mbledhjen e Kuvendit të Komunës, për arsye se ka udhëtim jashtë vendit, por e ka deleguar Drejtorin e Arsimit z. Fatlum Berisha për të nda dhënë sqarime.

Drejtori i Arsimit: Përshëndetje për të gjithë. Për arsye që Drejtori i Kulturës, Rinisë dhe Sportit gjendet në udhëtim jashtë vendit, unë do ta përfaqësoi dhe do ta elaboroi në vazhdim 'Projekt-Planit Komunal për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore për vitet 2025-2027', ashtu siç edhe e dini, ata të cilët kanë qenë pjesë e Ekzekutivit të Komunës, një plan të tillë nuk e kemi pasur deri

tani Zyrtarja për Kulturë, Rini dhe Sport, ka punuar në hartimin e këtij Planit Komunal për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore, ashtu siç e dini që shumica e objekteve për trashëgimi kulturore, menaxhohen direkt edhe nga Ministria e Kulturës, Muzeu apo Institucionet Arkeologjike në nivel vendi, qëllimi i këtij 'Planit Komunal për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore', në shumicën e rasteve ka të bëjë me listimin e trashëgimisë kulturore në Fushë-Kosovë, ky plan është në shqyrtim të parë. Lista e Mbrojtjes së Trashëgimisë Kulturore në Fushë-Kosovë janë: Nekropolis Mesjetar është një pjesë e Trashëgimisë Kulturore në Graboc të Poshtëm - Fushë Kosovë, Fortesa Parahistorike në Bardh të Madh, Kalaja e Harilaçit në Harilaç - Fushë-Kosovë, Lokaliteti Arkeologjik Metkovica në Miradi të Poshtme - Fushë Kosovë, Fortifikata Maja e Zezë Graboc i Epërm, Lokaliteti Neolitik në Nakaradë - Fushë-Kosovë, Kisha e Shën Ekatarinës, Bresje - Fushë-Kosovë, Ish Baza e Ushtrisë Italiano-Gjermane dhe Ish/Stacioni Hekurudhor, ndërsa lista e objekteve të luajtshme janë: Pjatë - Bardh i Madh, Byzylyk - Graboc i Poshtëm, Peshorja - Muzeu i Hekurudhave - Fushë-Kosovë dhe Lokomotiva me avull - Fushë-Kosovë. Ky plan na orienton tek pikat më të favorshme për vizitorë.

Laureat Gojnovci: Në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa, ka qenë prezent Drejtori i Kulturës, Rini dhe Sportit, i cili na i ka dhënë sqarimet për këtë projekt dhe ka treguar, pse projekti në fjalë nuk është finalizuar për arsye të kohës dhe ka kërkuar mirëkuptimin tonë, që të kalojë për arsye të afateve ligjore dhe procedurave tjera në diskutim publik dhe deri në shqyrtimin e dytë të plotësohet me gjitha ndryshimet të cilat kërkohen nga ky Kuvend i Komunës, ne në parim e mbështesim aprovimin e tij, sepse Komuna e Fushë-Kosovës nuk e ka pasur një plan të tillë asnjëherë.

Vlonjat Hasani: Planit Komunal për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore, e diskutuam edhe në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa, drejtori i cili ishte prezentë për fat të keq nuk mundi, as me arsyetuar projektin në fjalë si dokument me rëndësi publike për komunën, as me dhënë një shpjegim të duhur, se çka përmban, çka duhet me përmbajtur dhe si duhet me ju qas përpilimit ose hartimit të një projekti, i cili na ka ardhur këtu përpara, këtë projekt e ka punuar një profesioniste e fushës, por nuk e ka punuar Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport dhe për këtë arsye kishte mungesë të informacioneve dhe na ka ardhur shumë i dobët në përmbajtje, arsyetim të cilin e dëgjuam nga kolegu, por edhe në komitet ishte, se ka qenë një kohë shumë e shkurtër dhe s'kemi mundur me bërë me detaje, e që normalisht ky projekt është dashur të jetë, që prej pas luftës, ky dokument për komunën. Komuna si institucion me ditë saktësisht ku ka objekte të trashëgimisë kulturore. Ne po thirrmi që kemi me i mbrojtur disa objekte të trashëgimisë kulturore, kurse jemi komuna që me dorën e vet, bënë rritim të objekteve kulturore brenda territorit të saj. Nëse duam të punojmë mirë, është mirë që të merret me këtë punë një grup, të punoi në hartimin e këtij dokumenti, po ashtu të mirët parasysh edhe Komiteti për Arsime Kulturë, Rini dhe Sport, të cilët mund të japin kontribut të drejtë, në hartimin e këtij dokumenti. Ky dokument do të jetë publikë dhe duhet të jetë i duhur. Nëse duam ta kemi një dokument siç duhet është mirë ta kemi një gjithëpërfshirje dhe të kontribuojmë të gjithë, ne në këtë formë nuk e mbështesim.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Të nderuar kolegë 'Planit Komunal për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore për vitet 2025-2027', bazuar në atë të cilin nuk kemi pasur fare deri tani,

unë mendoj se është për mrekulli, sepse bazuar edhe në faktin që ne asambleistë nuk jemi në gjendje një plan të punës sonë me votuar, për tjerat është problem me bind dikom me votuar. Nuk e di se a keni lexuar këtë projekt-plan, sepse po ta kishit lexuar, mendoj se secili kish me dal sot këtu dhe me mbështet, duke u bazuar në atë që për njëzet e pesë vite, nuk kemi pasur, pas kësaj kohe po hedhet një gur themel në projektin e parë dhe ju nuk dhatë këtu asnjë propozim, jepen propozimet dhe i qesim në votim. Janë prioritet të cilat si kemi, është mirë me filluar, ama mangësi ka, po zero nuk mundemi me thanë. Themelimin e Qendrës Informuese dhe këtu i keni paraparë gjithsej 15,000.00€ për dy vite 2025-2026. Konservimi dhe restaurimi i artefakteve, keni paraparë 7,500€ në vitin 2025 dhe 7,500€ në vitin 2026, ku këtu totali është 82,000.00€, unë pyes ku keni me i marrë për ta zbatuar këtë. Kur e kemi votuar buxhetin, nuk e di se kemi ndarë një shumë prej 82,000.00€ dhe kjo më shqetëson, nëse nuk i keni paraparë me buxhet, ka do t'i merrni mjetet financiare me e zbatuar këtë projekt. Unë mendoj që është një bazë e mirë dhe e mbështesë.

Fisnik Sllamniku: Ne si Grup Parlamentarë i Lidhjes Demokratike të Kosovës e mbështesim, unë besoj se këto të dhëna janë marrë nga ekspertët, është një historian z. Jusuf Osmani, i cili është ndër hulumtuesit më të mëdhenj dhe besoj se kanë saktësi 100%, sepse janë profesionistë të jashtëzakonshëm. Ne tani e kemi një bazë, ku dimë me u referuar, ka dal edhe një libër dhe është bërë një punë e mirë dhe mendoj se duhet me u përkrah kjo iniciativë e mirë.

Mirsad Qyqalla: Planit Komunal për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore për vitet 2025-2027, kjo është me interes të gjithëve dhe atë trashëgimi të cilën e kemi me ruajtur, ka nevojë për dokumentacion shtesë, sepse është pak i mangët, ne e dimë se është në mbështetje të Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit, mirëpo çka po më bënë përshtypje është Themelimi i Qendrës Informuese për zonat parahistorike - Fushë-Kosovë dhe monumenteve tjera arkeologjike, atë ditë ishte më shumë fokusi tek shenjëzimi i tyre, mirëpo ne nëse nuk merremi në gjendjen ekzistuese, me i parë aty, nuk gjen asgjë. A ka ndonjë bisedë mes Ministrisë së Kulturës Rinisë e Sportit dhe Komunës së Fushë-Kosovës, se çka mundemi me bërë në këtë drejtim dhe nëse ky plan është bërë, pse nuk është paraparë me planifikimin e buxhetit.

Hasan Ismajli: Ky plan është i mangët, por këta e kanë pasur parasysh që kanë me sjellë deri në fund të vitit në Kuvendin e Komunës, këtë plan dhe nuk e kanë paraparë asnjë cent me buxhet për këtë plan, këtu po shihet edhe interesimi, sepse kjo nuk mundet me u realizuar dhe unë nuk marrë pjesë në votim.

Durim Hajra: Ka shumë mangësi 'Plani Komunal për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore', ky plan nuk ka ardhur as në Komitetit e Arsimit Kulturës Rinisë dhe Sportit, kjo nuk është në rregull, ky plan është dinamik dhe nuk i plotëson kriteret. Ne nuk mundemi me votuar.

Drejtori i Arsimit: Planit Komunal për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore për vitet 2025-2027, janë nëntë pika, pika e parë dhe pika e gjashtë, nuk ka fare të planifikuar buxhet për arsye të ndryshme, pika e dytë themelimi i qendrës informuese, duhet ta keni parasysh që ky plan është i bazuar në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve dhe me thënë një buxhet, të cilin e keni votuar ju, paret për trashëgimi kulturore në vitin 2025 nuk i keni të planifikuar nuk e keni mirë, se ka në kodin e mallrave dhe shërbimeve i specifikuar me buxhet për trashëgimi kulturore, i cili i specifikon aktivitetin e nesërme dhe në cilën do pikë, kemi të bëjmë me aktivitete, dokumentim

dhe konservim të artefakteve. Ministria e Kulturës, në baza vjetore ndanë buxhet jo vetëm për Komunën e Fushë-Kosovës, por për të gjitha komunat dhe njëkohësisht tenton me bashkfinancuar projektet nëpër komuna, edhe për Kalanë e Harilaçit, ju e di mi Komuna e Fushë-Kosovës, ndanë mjete financiare bashkërisht me Ministrinë e Kulturës dhe bëjnë intervenime në fshat ku i sheh të domosdoshme, këtu s'kemi të bëjmë me investime kapitale, për ata nuk ka të planifikuar buxhet specifikë, por tek shërbimet kontraktuale, tek mallrat dhe shërbimet, në secilën do drejtori, është bërë edhe një rivlerësim i të hyrave vjetra dhe do të bartet në kode sipas nevojave dhe tek këto aktivitete, të cilat i kanë të planifikuara, do bëhet investimi prej mallrave e shërbimeve, prej bashkëfinancimit të projekteve. E rëndësishme është me faktua, shembull e keni Kalanë e Harilaçit. Pika një thotë ndalimi ndërtimit para trashëgimisë kulturore, pikërisht Kalaja e Bardhit të Madh, deri sa nuk figuron në sipërfaqe mundet një qytetarë me ndërtuar aty, po nëse ne e vendosim në plan, ne e mbrojmë dhe e listojmë në trashëgimi kulturore, a'ka mundësi me ndodh ndërtimi aty, jo nuk ka mundësi, e qëllimi është këtu.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Unë pyes çka nënkuptojmë me qendrën informuese, a'ka me u punësuar një person, i cili ka me u marrë me informimin e monumenteve të trashëgimisë e arkeologjisë dhe si i keni planifikuar këto 82,000.00€ dhe ku është kjo qendër, si e keni menduar.

Drejtori i Arsimit: Realisht këtu kemi të bëjmë me një plan dy vjeçar, themelimi i një qendre informuese, mund të jetë në objektin e Shtëpisë së Kulturës, aty janë disa zyre është një bibliotekë, pjesa e brendshme është në rregull, saktësisht a'kanë me kërkuar ekspert prej Ministrisë së Kulturës, nuk e di, si do të ndodhë. Ky plan kërkohet edhe si dokument ligjor, me pas komuna dhe hapi i parë, të cilin po e kërkojmë ne është transparenca. Unë të gjitha vërejtjet dhe sugjerimet që i keni dhënë në Komitetin e Arsimit i kam dhe ato janë të mundshme me i vendos në plan të punës dhe unë publikisht ju falënderoj, se ma keni lehtësuar punën brenda Drejtorisë së Arsimit.

Mirsad Qyqalla: Meqë po flasim për një plan, po më intereson ta dijë, çka ndryshon gjendja ekzistuese, dhe a'ka mundur me u zgjeruar ky plan, që këto trashëgimi të cilat jeni duke u marrë me to, me u bërë funksionale.

Vlonjat Hasani: Këtu është e rëndësishme të evidentohet secili historik, i trashëgimisë kulturore, cilat kanë me qenë veprimet konkrete, që kanë me u ndërmarrë, prej kësaj komune, kësaj drejtorie, e te cilat duhet të evidentohen, këto plane për shembull të objekteve të vjetra të shtëpive të kulturave, për shembull në Miradi të Epërme është rrënuar objekti, ka mbetur bosh hapësira aty, a'ka me u bërë prapë një Shtëpi e Kulturës apo jo aty? Tani është bërë një vite nga djegja e 'Shtëpisë së Kulturës' në fshatin Sllatinë e Madhe, nuk ka asnjë veprim nga komuna për mbrojtjen e objekteve të tilla.

Drejtori i Arsimit: Për zbulimin e kalave të ndryshme nuk jemi kompetent, këtu nuk kemi të bëjmë me investime kapitale. Kuvendi i Komunës para disa viteve e ka nxjerr një vendim, ku ai vendim e parasheh rrënimin e Shtëpisë së Kulturës në qytetin e Fushë-Kosovës dhe ai vendim për momentin, nuk është zbatuar deri më tani, është zbatuar një vendim tjetër i Kuvendit të Komunës, ku është rrënuar Shtëpia e Kulturës në fshatin Miradi të Epërme dhe sipas eksperteve të fushës nuk ka pasur asnjë vlerë arkitektonike dhe ka qenë rrezik për banorët. Sa i përket Shtëpisë së Kulturës

në fshatin Sllatinë e Madhe, ajo është djegur, nuk ka asnjë vendim, që të kthohet në gjendjen funksionale.

Pas sqarimeve Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e çiti në votim për aprovim në parim për diskutim publik 'Projekt-Planin Komunal për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore për vitet 2025-2027'.

U votua me: pesëmbëdhjetë vota 'për', asnjë votë 'kundër' dhe tre abstenime, gjithsej tetëmbëdhjetë anëtarë të pranishëm në mbledhje.

Ne bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës me shumicë të votave e aprovoi në shqyrtimi e parë dhe kalimin në procedurën e diskutimit publikë 'Projekt-Planin Komunal për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore për vitet 2025-2027' dhe mori:

V E N D I M

1. Për aprovimin në parim për diskutim publikë të Projekt-Planit Komunal për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore në Komunën e Fushë-Kosovës për vitet 2025-2027.
2. Projekt-Plani Komunal për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore në Komunën e Fushë-Kosovës, parasheh Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore për vitet 2025-2027, në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës.

Pika e gjashtë (6) - Propozim për ndryshimin e vendimit Nr. 88, të datës 25.06.2024 për anëtarët e Komisionit për rekrutimin e Drejtorëve dhe Zëvendës Drejtorëve në institucionet arsimore të Komunës së Fushë-Kosovës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim 'Propozimin për ndryshimin e vendimit Nr. 88, të datës 25.06.2024 për anëtarët e Komisionit për rekrutimin e Drejtorëve dhe Zëvendës Drejtorëve në institucionet arsimore të Komunës së Fushë-Kosovës', ftoi Drejtorin e Arsimit që të na jap sqarime.

Drejtori i Arsimit: Plotësimi-ndryshimi i vendimit Nr. 88, të datës 25.06.2024 për anëtarët e Komisionit për rekrutimin e Drejtorëve dhe Zëvendës Drejtorëve në institucionet arsimore të Komunës së Fushë-Kosovës, duhet të bëhet sepse ky komision është formuar për zgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve në institucionet edukativo-arsimore, në këtë rast kemi të bëjmë me Çerdhen e Fëmijëve 'Gëzimi Ynë' në Fushë Kosovë, në momentin që Kuvendi e ka marrë vendimin për formimin e komisionit, është shpallur konkursi dhe ne nuk e kemi ditur për kandidatët të cilët do aplikojnë dhe pas përfundimit të gjitha procedurave, vjen deri tek konflikti i interesit, sepse kunata e njërit anëtar të komisionit ka aplikuar dhe pas konsultimit, edhe të Zyrës Ligjore kemi ardhur në përfundim që ky anëtar të zëvendësohet me një anëtar tjetër, për arsye të konfliktit të interesit. Po ashtu kemi biseduar edhe me Ministrinë e Arsimit, e cila na ka rekomanduar që ky konkurs duhet të ri shpallet prapë nga Drejtoria e Arsimit.

Laureta Gojnovci: Ashtu siç tha edhe drejtori, kjo çështje është më shumë procedurale dhe pas konsultimit me Ministrinë e Arsimit, u është rekomanduar që të ndërrohet anëtar i komisionit dhe të rishpallet konkursi. Në emër të anëtarëve të Grupit Parlamentarë të Lidhjes Demokratike të Kosovës, ne e përkrahim ndryshimin e kërkuar nga Drejtoria e Arsimit.

Vlonjat Hasanit: Ne nuk i përkrahim këto gabime të Ekzekutivit të Komunës, sepse edhe në këto komisione i kemi anashkalluar anëtarët e Kuvendit të Komunës, filloni me punuar ashtu siç duhet dhe me marrë më seriozitet punën e Kuvendit të Komunës.

Mirsad Qyçalla: Pasi që ekziston konflikti i interesit është mirë me u përmirësuar, por ju e kemi anashkalluar edhe Kuvendin në këto komisione dhe rrëqenëse, ju na kemi anashkalluar edhe ne nuk e përkrahim.

Hasan Ismajli: E jep saktë ligji dhe udhëzimi administrativ, çka është konflikti i interesit, por unë e kam një shqetësim timin dhe po hy direkt në pyetje, të njëjtin konflikt interesi e kemi edhe në konkursin për Institucionin Parashkollorë, një psikolog e cila nuk është pranuar por ka qenë kandidatë, është intervistuar edhe me shkrim edhe me gojë dhe Kryetari i Komisionit, që është Drejtori i Shkollës së Lismirit, i posa zgjedhur, është i afërt me familjarët e saj dhe udhëzimi administrativ, nuk e specifikon afërsinë, po thotë konflikti i interesit dhe në këtë konkurs drejtori dhe bashkëshorti i njëres prej kandidatëve janë kushëri dhe nëse shkruan diku afërsia ligjore, është mirë me na i treguar, sepse unë nuk e kam gjetë dhe nuk specifikohet afërsia.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Unë e kam një shqetësim dhe nuk do të marrë pjesë në votim, pyetja ime është pse duhet çdo herë në këto komisione me i vendos katër-pesë drejtorë të njëjtë, sepse po me duket se masë andej si rezultat që po ua kryeni punët, ju po ua punësoni gratë drejtorëve, do ta marr shembull anëtarin z. Salih Jashanica, i cili është ashtu siç po them unë.

Drejtori i Arsimit: Kolegu z. Hasan Ismajli, Ligji 06/L-011 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e detyrës, neni 1.6, personi i afërt me zyrtarin, bashkëshorti ose personi që bashkëjeton, të afërmit në vijë të drejtë të gjakut pa kufizime, të afërmit në vijë të tërthortë deri në shkallën e katërt, sipas drejtorit në fjalë, kandidatja e cila është pranuar në atë konkurs është e 13 në bazë të vijës së gjakut. Përfshirja e katër drejtorëve në konkurse, është shumë e qartë, z. Gëzim Berisha - Drejtor i Shkollës 'Laura Scotti' në Graboc të Poshtëm, afërsisht shkolla i ka 135 nxënës, z. Uran Tërnavë në shkollën e Lismirit afërsisht 130 nxënës, z. Sali Jashanica dhe z. Fidan Hasani drejtor të cilët e ushtrjnë funksionin e tyre në shkollat përkatëse dhe numri i nxënësve është shumë i vogël, detyrohen gjysmën e orarit me e bërë në Drejtorin e Arsimit të Komunës, pa kompensime dhe e vetmja arsye pse ata janë në komisione është kjo.

Pas sqarimeve Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e qiti në votim për aprovim 'Propozim për ndryshimin e vendimit Nr. 88, të datës 25.06.2024, për anëtarët e Komisionit për rekrutimin e Drejtorëve dhe Zëvendës Drejtorëve në institucionet arsimore të Komunës së Fushë-Kosovës'.

U votua me: trembëdhjetë vota 'për', asnjë votë 'kundër' dhe asnjë abstenime, nga gjithsej njëzet e gjashtë anëtarët e pranishëm në mbledhje, pjesëmarrja në votim nuk është e mjaftueshme për vendim marrje.

Ne bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës në mungesë të votave nuk e aprovon 'Propozimin për ndryshimin e vendimit Nr. 88, të datës 25.06.2024, për anëtarët e Komisionit për rekrutimin e Drejtorëve dhe Zëvendës Drejtorëve në institucionet arsimore të Komunës së Fushë-Kosovës.

Pika e shtatë (7) - Pyetje dhe përgjigje parlamentare.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Tani e kemi pikën 'Pyetje dhe përgjigje parlamentare'. ftoi anëtarët e Kuvendit të Komunës që të parashitrojnë pyetjet e tyre për Ekzekutivin e Komunës.

Hasan Ismajli: Për Drejtorinë e Arsimit pyes është një subvencion në shumën prej 1.500.000€, nga Drejtoria juaj, e që i bie që djali im e ka marrë me një grup të arsimtarëve, për një projekt, unë kërkojë nga ju për të qenë i saktë, me udhëzim administrativ obligohesh me krijuar një komision monitorues dhe unë kërkoj që nëse nuk e keni formuar komisionin, ta formosh dhe ai komision monitorues ta ketë për detyrë, që atë projekt, në shumën e atyre të hollave të barazohet me fatura, po ashtu kërkoj nga ju që përmes komisionit monitorues, për çdo faturë me dal në vendin e ngjarjes ku është investuar dhe në mbledhjen e ardhshme me na sqaruar. Po ashtu pyes, si është e mundur, që në konkursin për psikologe e keni pranuar një punëtorë, që përveç që nuk është banorë e Komunës së Fushë-Kosovës, është psikologe e cila licencën e ka prej Odës së Infermierisë së Kosovës dhe është psikologe klinike dhe ajo psikologe klinike, a ka për detyrë me na i ekzaminuar fëmijët në çerdhe, apo në shkollë në mënyrë psikologjike dhe këtu nuk pranohet dikush tjetër, edhe pse e ka fakultetin, masterin në institucione shtetërore.

Durim Hajra: Po filloj me Drejtorinë e Arsimit, meqenëse drejtori është këtu, me vizitën e fundit që Komiteti i Arsimit, Kulturës, Rinisë dhe Sportit e ka pasur në dy anekset e shkollës 'Mihal Grameno', konkretisht 'Aneksi 1' dhe 'Aneksi 3'. I nderuari drejtor, pas këtij takimi i kemi bërë ftesë drejtorit me qenë prezentë në mbledhjen e këtij komiteti, herën e parë ka dështuar herën e dytë, ka pas kuorum u mbajt dhe ju nuk i jeni përgjigj ftesës së komitetit, edhe pse obligim ligjor nuk e keni por moral, po nëse jo, ju me deleguar dikën nga drejtoria. Në atë takim kanë marrë pjesë mësimdhënës, këshilli i prindërve, e që sinjerisht për hirë të korrektësisë, ne pritëm që ju po vini në një mbledhje të komitetit, Kërkesë e Këshillit të Prindërve ka qenë, që dikush me u merrë me këto ankesat dhe vërejtjet tona, unë do i përmendi këtu ato të cilat u thanë tek 'Aneksi 1' i shkollës 'Mihal Grameno' në Fushë-Kosovë, tavani i shkollës pikon dhe pengon në mbarëvajtjen e procesit mësimorë, inventari i shkollës është i dëmtuar dhe ishte ankesë, edhe e Këshillit të Prindërve edhe mësimdhënësve, ndriçimi jashtë oborr të shkollës është jo funksional, gjeneratori jashtë funksionit, për arsye se s'ka person përgjegjës, mungon biblioteka në 'Aneksin 1' dhe në 'Aneksin 3', siguria e nxënësve dhe mësimdhënësve lënë për të dëshiruar, për arsye se është vetëm një person përgjegjës, higjiena, një mësimdhënës na u lut që të vijmë gjatë pushimit të nxënësve për arsye të mungesës hapësirave dhe mungesës së mirëmbajtësve, vetëm katër tualete për 1500 nxënës, me dy ndërrime, e në 'Aneksin 3' mungon trrethoja, ka mungesë të stafit teknik, edhe në 'Aneksin 3', hapësira është deshtë me qenë minimale klasat e vogla, me nga 35 nxënës, ndriçimi i jashtëm, pragu i dritareve i ulët, inventari shumë i dobët e pamë edhe vet, mungon kabineti, mungon printeri shumë e çuditshëm tek 'Aneksi 3', ishte jo funksional. Në lagjen 'Dardania' për një shenjë që nuk e qesin ka mundur me shkuar deri tek më e keqja, ku u deshtë me intervenuar policia, sepse ka shkuar deri në konflikt personal, sepse Drejtoria e Inspektoratit i neglizhon këto, drejtori i cili se zoton punën është mirë me lëshuar krejt drejtorin. Pastrimi i kufomave me qitë një barrierë sepse është shumë afër shkollës dhe ka qarkullim të nxënësve.

Habib Mekolli: Kam një pyetje për Drejtorin e Arsimit, çështja e nxemjeve të objekteve shkollore, u bë një çështje e madhe, shumë e pa këndshme, në objektin këtu afër para disa ditëve, dilke një trym dhe një numër i banorëve i bërtitshin punëtorit i cili ndez zjarrin, tani në objektin ku jemi është ndërtuar sistemi dhe jemi komod sa i përket nxemjes, mendoj se janë lënë pas dore shkollat se paku të na sigurojnë një sistem si këtu në komunë.

Vicent Hasani: Rruga 'Lumi' në fshatin 'Miradi të Epërme' në të cilën nuk po mirët as një veprim, prej Ekzekutivit të Komunës për me rregulluar këtë rrugë. Pastaj ka ankesa për degradimin e lumenjve, në lumin Graçanka, të paktën me pastruar, sepse i takon komunës. Banorët e objektit ACL-së kanë mungesë të kontejnerëve dhe kanë probleme me mbeturinat, kështu që po kërkojnë zgjidhje më të shpejtë. Rruga 'Shtëpia e Kulturës' në Miradi të Epërme, banorët kanë probleme me kanalizimin. Një pyetje për çeshmet në tualetet e komunës në katin e parë janë tmerruese, duhet me u shërbyer me shishe dhe me tasa, kjo është e çuditshme, Kur është koha e fundit që sallat e renovime me u vendos pajisjet, janë rinovuar për herën e dytë dhe prapë janë si herën e parë.

Mirsad Qyqalla: Dua të pyes Drejtorin e Arsimit, cili është problemi me rrymën në shkollën e fshatit Pomozotinit.

Drejtori i Arsimit: Po filloj me përgjigjen e z. Mirsad Qyqalla, kemi pasur problem me poça në shkollën e fshatit Pomozotin tani i kemi rregulluar dhe s'kemi problem me ndriçim. Po vazhdoj me z. Hasan Ismajli, konkursi i psikologes, nuk specifikohet a është psikologe klinike, sa i përket banorë e Komunës së Fushë-Kosovës, është e vërtetë por ligji i jep të drejta të barabartë të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës, pjesë e këtij konkursi kanë qenë edhe të tjerë kandidatë dhe komisioni ka qenë profesional dhe është në kompetencat e komisionit. Pyetja e z. Durim Hajra ishte mospjesëmarrja në Komitetin e Arsimit, Kulturës, Rinisë dhe Sportit, kërkoj falje, unë zakonisht mundohem me qenë deri në momentin e fundit dhe nuk tentoi me i ikë përgjegjësi. Unë i kam shkruar të gjitha ankesat por disa nuk janë në domenin tim, shembull ndriçimi publik nuk është në kompetencën time, ne se bashku me Zëvendës Drejtoreshën e 'Aneksit 1', kemi tentuar, atë pjesë me mbyll, por në mungesë të hapësirave u deshtë me lënë dhe krejt mundësitë çka kemi pas mundësi me i bërë, i kemi bërë të gjitha. Mungesa e kabineteve në disa shkolla është e vërtetë që mungojnë, po në disa janë, këtu faji është edhe tek mësimdhënësit, sepse vetë mua më ka rastisur, që kam shkruar në kabinet dhe skeletin e kam parë në paket, s'kanë pas vullnet as prej paketës me larguar. Vetëm katër tualete, s'mundem me bërë tualetet tjera, sepse ndërtimi është në atë formë, mungesa e mjeteve higjienike shkojmë në cilëndo shkollë dhe nëse nuk gjejmë mjetet higjienike rezervë edhe për gjashtë muaj, unë do të jem përgjegjës, ndërsa sa i përket stafit kemi mungesë, edhe të stafit teknik. Për bibliotekat, kam ndarë buxhet specifikë, për blerjen e ekzemplarëve të ndryshëm për t'i pajisur, bibliotekat e shkollave apo këndeve të leximit. Pjesa e administratës është një situatë, ku nuk kemi mundur për gjashtë muaj me bërë, aty don vendim strikt cilat klasë kanë me qenë në shkollë. Kjo nuk është fare problem, sepse janë shumë afër, mësimdhënësit ankohen në cilësinë e ndërtimit, po mundemi me u ankuar, sepse as unë s'jam inxhinier dhe s'di si duhet me bërë këtë punë, unë kërkoj bashkëpunim me të gjithë. Siguria në 'Aneksin 3', në paramasën ekzistuese, rrethoja përfundimtare nuk është, ka qenë e planifikuar por nuk e ka bërë dhe ne paret nuk ua qesim për atë që nuk është kryer. Nxemjet në shkolla që u cekën


nga z. Habib Mekolli, të premtën nëse nuk kishim mundur me i furnizuar me dru shkollat, unë kam pasur me ardhur edhe me ju treguar lëndën të cilën unë e kam dërguar në prokurim për shkak të vonesave të tyre, mua më ka thirrur një qytetarë dhe me ka thënë shiko në dritare dhe shiko tymin, eja ndërto oxhakun vetëm një metër më lartë dhe ky tym do të largohet, por unë nuk kam pasur mundësi.

Pika e tetë (8) - Të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Tani jemi në pikën 'Të ndryshme', ftoi të pranishmit nëse kanë ndonjë çështje për diskutim.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës falënderoi të pranishmit për pjesëmarrje në mbledhje. Mbledhja përfundoi në ora 15:25 minuta.

Procesmbajtës
Hasan Gjyrevci



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Ali Ismaili

